

Kemi rënë tashmë nën frekunecat e poezisë së Gjekë Marinaj. Edhe në një grupim të caktuar stile mash poetike me temë humane, filozofike e më gjerë, poeti ka me vete besimin dhe energjinë e ekzekutimit të asaj që beson, sikur një shenjt...

Poezia si fletë Bible e Gjekë Marinaj

Për vëllimin e ri poetik "Lutje në ditën e tetë të javës" të poetit Gjekë Marinaj

Dhurata Hamzai

KUR NË REVISTËN "The Brookhaven Courier" shkruhej se Gjekë Marinaj është shembull natyral i poetit tokësor, njëkohësisht, duke lexuar poezitë më të fundit të tij, po mendoja se nuk kisha hasur ende një natyrë poeti kaq në harmoni me shpirtin, trupin, lëndën dhe qiellin dhe nuk më largohej ndjesia e habitës se si, edhe i bërë kështu, ky njeri nuk jeton dot pa ritmin e poezisë. Habitesh edhe më tepër kur e di se poeti Gjekë Marinaj beson që poezia:

*"Digjet pa lënë hi
Në sytë e poetëve
E njelmëta e lotit të njeriut dhe Zotit"*

Shih ("Poezia", fq 71, nga libri "Lutje në ditën e tetë të javës"). Jo vetëm poezia, por gjithçka që i përkushton vargjet Gjekë Marinaj, është e prekshe, sa gjasë humane dhe tokësore. Kjo përkon me aktin e kthjellimit poetik të poetit që ka mbërritur në prag guximi, ku ndjen se tashmë poezia e tij është e mbarsur me stilin vetvetiu, është kockëzuar me identitetin e autorit, lulëzon falë ushqimit me talentin.

Një poet i pasigurt do të kishte frikë të zhyste imagjinatën e tij në një materie perceptualisht më pak poetike, pa u mbështetur mirë në pjellorinë e fantastikes. Pra, edhe pse me materie kaq konkrete mbarsur, kaq e prekshe, e ngarkuar, e lëndët, inpoetike në dukje, poezia e Marinaj vjen tek lexuesi sërish prej një dukurie jo aq lëndore sa i përket atij inspirimit të parë, prejës së parë të imazhit, por më tepër ajo ndihet në formën e trandjeve të disa frekuencave valore. Ajo sillet vërtetë si një valëzim rrëqethës kur rrekesh të bashkohesh në këndimin dhe aktrimin e saj. Po ta perifranojmë një varg të këtij vëllimi poetik, poeti na thotë se frekuenca e ndjenjave të tij mirëpret transmentimin e zërit tonë.

Duke u zhytur lexuesi në frekuencat e kësaj poezie trazohet si në një seancë këndim-rrëfimi afër shenjtëritimit. Tingujt muzikor kanë hyrë dukshëm në poezinë e Marinaj, duke zhvendosur fjalët me kuptimin e tyre të beftë zazor, pastaj zbulesat poetike, pasi tingulli ka lakuar melodinë e poezisë, sillen si fjalë në formën e rrahëve koncentrike edhe shënohen me një vërtetësi të ndjerë bukur nga poeti. Të



Kopertina e librit të Gjekë Marinaj «Lutje në ditën e tetë të javës»

"Kur miku im, Prof. Jerry Kuye, më tha se kishte zbuluar një poet të veçantë nga të gjithë poetët që ai kishte lexuar më parë, mendova se poezitë (që mi la për t'u hedhur një sy) do të ishin të shkruara me numra apo simbole abstrakte e jo me shkronja. Vetëm pasi i lexova ato, të cilat mbanin për autor poetin Gjekë Marinaj, e kuptova se ku ishte fjala. Nëse Marinaj vazhdon të shkruajë kështu, ka gjasa se një ditë jo të largët, e gjithë bota letrare do e kuptojë domethënien e fjalëve vlerësuese të Prof. Kuye-s për Gjekën."

—Wole Soyinka, fitues i Çmimit Nobel në letërsi, 1986

ndiesh bukur, është një tjetër e sjellë humane që s'i ndodh kujtdo. Nëse rrëshqet vështrimin mbi vargjet:

*"Fryma e malësore holluar në tinguj.
Zgjoji ngadalë bjeshkët e përgjumura"*

dëgjon konkretisht gjallimin e këtyre tingujve poetikë:

*"pishë më pishë e ah më ah
rrënjët e njoma nëpër lëndina
Ndjenë ardhjen e qumështit të parë.
Luleshtrydhetukthehenparakohënrutya"*

(Shih aty, "Këngëtarja e bjeshkëve").

Tingullit të rrëfimit poetik të Gjekë

Marinaj i shtohet si zë muzikor edhe dukuria e metrikës së vargjeve harmonike, nota muzikore të së cilës i për-bashkohen një kompozimi të veçantë tingullor edhe më të plotë. Edhe pse stilemat poetike kanë ndërruar modë sot, poeti Gjekë Marinaj nuk ka drojë se duke gdhendur vargje në forma të prera klasike do të humbas së paku shije për modën ose modernitetin e sotëm poetik. Marinaj madje e pasuron luleshën metaforike të vargjeve me muzikalitet përbri të jashtëzakonshmes deri në nuanca sharmante. Vargjet qëndrojnë të mahnitshëm edhe kur janë përplot me muzikalitet, ato sikur komunikojnë me formatin tjetër të vjershërimit për të mos e lodhur shi-

jen e veshit të lexuesit prej shpërthimit të muzikorit si një instrument në varg, sepse poeti Marinaj gjen metafora të jashtëzakonshme për të sjellë atë që do-të gjithën poezi. Kjo ndodh shi tek poezia "Ku kam qenë mbrëmë" dhe poeti që thotë:

*"Ku lumi ndal të lidh fjongon
Ku valëzimi i ujit ëmbël rimon
Ku penat vijjnë të mendohen
Ku hëna gjatë natës përgjon"*

Deri ku mundet të shkojë frekuenca metaforike e kësaj poezie, kur fryma të mbahet edhe ritmikisht nga mahnitja prej lumit që "ndal të lidh fjongon".

Në metamorfozën poetike

Poezia e Gjekë Marinaj siç thashë më lart të përpin në zhytje dhe kjo nuk qëndron larg asaj që përjeton poeti në vetvete, për vete dhe të tjerët. Në të gjithë vëllimin poetik poeti mban një distancë të bukur nga egoja e tij, ndërsa rreket në kërkim të dritës shpirtërore që sapo na e thotë me vargje e forma, e tema artistike, Ai, pra, rend të pohoj në vargje atë që jo më larg e ka parë e ditur në jetë. Në një intervistë dhënë për të përditshmen "TemA" në Shqipëri, ku pohon se "shpirtërisht jam vendlindja", Marinaj është shprehur se "si poet e gjej veten të zhytur përherë e më shumë në dritën e estetikës, të studimit të përhershëm të artit të bukurisë në jetë". Duket se Gjekë Marinaj përballet me një ndriçim të atillë që do të na e thotë në poezinë "Lutjet e së dielës" derisa sa të dalim tek metafora e çuditshme "Lutje në ditën e tetë të javës" përdorur në një njëriën nga poezitë që ka pagëzuar edhe vëllimin poetik me emrin e saj. Le të shkruajmë të plotë këtë poezi që do të zëvendësojë njëkohshëm pohimin e poetit për veten në publik:

*"Këtë të dielë u luta për Republikën.
Kanibalët të shpërthejnë kthetra
e të bëhen kafshë.
Kafshët të zbuten e të bëhen humane.
Humanët të lëshojnë krahë
e të bëhen engjëj.
Engjëjt të zbrasin nga Parajsa
e të bëhen poetë.
Poetët të shkrihen në vargje
e të bëhen poezi.
Poezia të pësojë një tjetër metamorfozë
e të bëhet
Prova e së vërtetës objektive të Platonit"*

Prore këtyre vargjeve, logjikisht na del në funksion të zbulimit që të kuptojmë edhe se çfarë është dita e tetë e javës. Në metamorfozën poetike të Gjekë Marinaj, shpallur si një lutje

sublime në formatin e saj përshkrues mund të kuptojmë edhe shkakun e këtij dëshirimi poetik për këtë lloj metamorfoze të ëndërruar me aq shumë sinqeritet. E kështu gjejmë kuptimin, por edhe kështu saktë si lexues ndiejmë edhe nevojën e "ditës së tetë të javës". Abstraktimi i ditëve e ka një arsye; çbërja e gjasave jetësore dhe lutja për fenomenin e përmbysjes ka të bëjë me konsumimin e universit moral, shqisor e ndiesor të njeriut, por Marinaj nuk shpërfaq figuracione surreale për lexuesin në këtë shfityrim, por kundër "rrymës" në mënyrë të habitshme ndërron rrjedhën e metamorfozës, që rëndom në arte e letërsi shfaqet me rënie, qoftë kjo edhe një rënie metaforike. Gjekë Marinaj si poet këndell ngritjen, shpresën, por në një variant të besueshëm e organik, ai e shqetëson të gjithë dukurinë e shdërrimeve me një shtyrje të frekuencave shpirtërore deri në lartësim (duhet t'i mbetemi besnik fjalës frekuencë deri në fund, sepse siç e thotë edhe vetë poeti, poezia e tij nuk mund të interpretohet pa frekuencat si dukuri). Pra, kemi rënë tashmë nën frekunecat e poezisë së tij. Edhe në një grupim të caktuar stile mash poetike me temë humane, filozofike e më gjerë, poeti ka me vete besimin dhe energjinë e ekzekutimit të asaj që beson, sikur një shenjt. Duhet thënë se të gjitha përcaktimet që bëjmë për poetin nuk janë stisje të rastit. Vetë gjurmët e të shkruarës në poezi mbartin mesazhe të kësaj natyre, që shquajnë poetin, vargun, metaforën në një një kod të ngjeshur poetik, megjithatë të shprehur qartë e të perceptuar qartë.

Poezia digjet, pa lënë hi në sytë e poetëve...

Poeti ka të drejtë kur thotë se ai na dhuron frekunecat dhe ne marrin zërin prej poezisë së tij. Poezia e tij ka ndikimin e njëjtë me një prekje magjike çudibërëse. Fjala dhe frekunecat valore, turbulluese, drithëruese sido që ta shkatojnë prejken janë lënda e parë e poezisë që të nxit aftësinë për t'u perceptuar qartë. Shih tek poezia ku kam qenë mbrëmë, poeti dëshmon se këto tinguj, kjo muzikë këto frekuenca janë të pranishme, ato duket sikur lundrojnë në imagjinatë me shpejtësi dhe na nxisin në lëvizje, na zgjojnë një ndjesi të mirë dikur të mrolur. Në lundrim pas zhytjes së ëndshme gjendemi atje ndaj vargjeve të poetit:

*"ku brigjet janë mëse metafora.
Ku uji flet në rrokje me saktësi.
Ku yjet zbrazin shkëlqimin.
Ku dallgët takohen në fshehtësi."*

« Besimi në qenësinë e jetës, frymës e shpirtit ka një ligjësi që pasuron njeriun brenda poetit dhe pastaj poetin brenda njeriut. Kështu si më sipër foli ai poeti, ndërsa i thotë Gjekë Marinaj njeriut:

*“Ku zoti mban syrin e gjelbër
Ku lumi rrjedh dhe vezullon
Ku poezia qiellin fort godet
Ku poeti fjalë të reja flakëron.”*

Poezia sipas Marinaj është më e brishtë se jeta, universi, Zoti vet.

*“Digjet pa lënë hi
Në sytë e poetëve
E njelmëta e lotit të Njeriut dhe Zotit
Më shumë se një grusht flakë
për Feniksin”*

Përveçse e drojtur për arsye se i nevojitet brishtësia në konsistencën e saj si krijesë e ngjizur e gjallnuese, poezia e Marinaj nuk është inferiore në rrafshin universal. Ajo mandej, është dukuri lëndore që shkakton kaq shumë dukuri frymore. Poeti thotë tek “Poezia”, fq 71 se:

*“çdo fjalë
lëshon tinguj marramendës
nga kontakti i filozofisë
me ndjenjën.”*

Marrëdhëniet intime me poezinë

Sapo u njohëm me rrethinat poetike të Gjekë Marinaj, marrëdhëniet e tij intime me poezinë dhe prurjet e reja në vargje, por nuk do të mjaftonte kjo nëse do të linim pa përmendur një varg metaforash, hiperbolash e stile-mash poetike të rralla, befasuese, të cilat e bëjnë edhe më të veçantë poezinë e Marinaj. Për shembull: vajza që ka dashur dikur poeti-“diellin e dehte me fytyrën e bardhë”, puthja e parë-“fijën që më lidhte me botën e digjte” nga mungesa-“ëndrrat të përloitura në fytyrë u zbehën”, pranvera-“i zhvishet si një metaforë e shpikur prej diellit”, poeti Gjekë-“si një breg i zhgënjyer nga magjtitë e bukura të detit”, ndërsa

në ëndërr nëna i shfaqet mes dhimbjes paradoksale-“Ajo është tepër e re që të vdes/E tepër e lodhur që të rroj”. Ende ke rast të dallosh figurat letrare kur:

*“duart e nënës janë mozaik hallesh
Duart e saj prej shenjti
Porte ku vaporet e vuajtjeve
ndalojnë për të kaluara natën”*

E gjithë struktura tematike e këtij vëllimi përmbledhet në një mozaik hallesh, gëzimesh e lumturish të përbotshme, por poezia e Marinaj, në thelb, nuk të lë kurrë kohë të merresh gjatë me objektin tematik. Në asnjë rast tema poetike për këtë poet nuk është qëllim në vetvete. Poezia e tij vjen e mbartur, madje pa kohë, pa moshë. Jo rrallë temat janë marrë nga Shqipëria ku kaloi rininë e hershme poeti, ndërsa kënga (vargu) këndohet atje në Amerikë, ku ai jeton prej 17 vjetësh dhe është vlerësuar nga poetët e mëdhenjë amerikanë.

Polisferat

Të flasësh mbi poezinë e Marinaj të duhet të lundosh shpesh nëpër polisferat e të gjithë materies së tij poetike. Sapo prek njërin vëllim, me siguri ngel gjatë aty, zë bashkohesh me zërin e vargut dhe nuk rresht së zbuluari gjithandej, mënyrën si poeti këngëzon poezinë, mënyrën si poeti të elektrizon me ndjesitë, mënyrën si poeti të shqetëson me shqetësimin e tij, të bën të dashurosh për dashurinë e tij, mënyrën se si poeti të përul deri në përбетim në besimin e tij. Mënyra si do e dashuron ky poet për shumë të tjerë ndoshta është një shpresë e së ardhmes...! Në këtë vëllim lexuesi do të dridhet nga rezonancat e një energjie ndijesore, inteligjente, erotike dhe hyjnore. Titulli i mësipërm imi, Poezia e Gjekë Marinaj si fletë bible, ndikohet nga shtresëzime të vargut e të poli-sferave parardhëse të krijimtarisë së tij, përveç zbulësive të aktit poetik që lë më pas një gjurmë besimi të përkorë tek lexuesi. Akti poetik është i përkryer falë kërkimeve në

strukturën e figurën poetike, po aq sa në dashuri. Shi, janë këto që krijojnë edhe marrëdhënien më intime të poezisë me poetin, sekretin e vetëm që mezi shquhet nga lexuesi, ndërsa shtresëzimet e mëpastajme shtyhen në një rreth tjetër marrëdhëniesh, pas intimes si shkak, tek mendimet publike të poetit për jetën, njeriun dhe Zotin, të cilat të shtyjnë deri në skajin e një filozofie risthate që në rastin konkret për të mbetur kjo përvojë-përvuatje trashëgimi...-kryqëzohet sot jo më Krishti, por Poezia, Poeti. Këtu ndan dhe afron tepër-poezia e Marinaj, sikur thashë, “si fletë Bible”.

Sugjerim me zë të ulët

Në një shtrëngatë paradoksesh mes lëvizjes së imagjinatës dhe gjakut, poezia e Marinaj ofron një dashuri të madhe njerëzore, nëpër vargjet e tij takon njerëzit e dashur; nëna, babai, gruaja, nëna e shokut, miqtë dhe gjithësecili qaset si një zbulim i poetit-që veç ai e njeh humanin të krijuar veçanërisht diku në mister në frymim të shenjta. Dashuria e madhe e poetit për njerëzit spikat qashtë në çastin kur zbulon se askush prej personazhit të një poezie nuk i ngjan tjetrit. Zemra e poetit e ndjeshme i sheh aq hollë këto genie të dashura sa veç Krijuesi i tyre mund t'i shoh ashtu. Krijuesi i përbrendësuar në shpirt humani, me fill të kapur në tokën ku jeton njeriu e poeti është ndoshta vërtetë Zoti vetë. Pasi kemi kuptuar më mirë vargjet interesante tek poezia “Sugjerim me zë të ulët” shtyhem në meditim gjatë leximit të vëllimit poetik “Lutje në ditën e tetë të javës” shkruar nga Gjekë Marinaj:

*Një 60 e ca vjeçar e pyeti
Nëse Zoti është një fakt i madh
Apo thjesht një ide e madhe
Duket se madje edhe për ty, në një rreth
apo në tjetrën formë Zoti jeton, -i tha.
Edhe nëse nuk je i sigurt se ka Zot
Është mirë të besoh- vetëm në rast se ka”*

Çfarë duhet thënë për poezinë e gjekë Marinaj, nuk mbaron këtu...!



Kush është Gjekë Marinaj

Poeti Gjekë Marinaj jeton në Dallas të Teksasit

Është diplomuar:

Për Gjuhë-Letërsi në Tiranë
Në Insitutin e mjekësisë ASPT në Arlington (patologji Diploma)
Në Shkencat e Përgjithshme në Brookhaven College (Associate Degree)
Në Shkollën e Arteve dhe Humanizmit në Universitetin e Teksasit (Bachelors degree)
Për Letërsinë botërore në universitetin UTD (Masters Degree)
Dhe momentalisht jam duke studiuar për Phd. (doktoratura) (Studime të avancuara në letërsi) po në UTD.

Është:

Pedagog i Komunikimeve Gjuhësore dhe i letërsisë Botërore në Richland College, në Teksas.
President i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, të cilën e kam themeluar vetë në vitin 2001.
Ka futur Kadarenë (Ura me tri harqe) në programet mësimore në kolegjin ku punoj
Ka intervistuar ish presidentin George Bush, Pelen, sh. Perez, Kadarenë etj. për librin e tim me intervista “Ana Tjetër e Pasqyrës.”
Është i vetmi shqiptar në Amerikë që është anëtar i (ALTA— American Literary Translators Association)
Ndër të tjera ka marrë Çmimin e parë në poezi, dhënë nga Revista letrare Sojourn me rastin e 18- vjetorit të botimit të saj.
Ka modëruar disa konferenca letrare internacionale.
Është i martuar me Dusitën prej 16 vjetësh.

Ka botuar dhe përkthyer disa libra:

“Mos më ik larg”, 1995 - poezi
“Infinit”, 2000 - poezi
“Ana tjetër e pasqyrës”, 2003 - intervista
“Ora e paqes”, 2005, përkthim - poezi nga Rainer Schulte
“Në shpellën e Platonit”, 2006, përkthim - poezi nga Frederick Turner
“Poezia Bashkëkohore Amerikane,” 2006 –Antologji e poezisë bashkëkohore Amerikane-përkthim.
“Ca gjera nuk mund të mbeten sekret”, 2007-publicistikë (do ta japin ose tonini ose Muja)
“Lutje në ditën e tetë të javës” 2008-poezi



Gjekë Marinaj
me bashkëshorten
Dusita, Maj 2007 ▶